



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 7

Nëse na bashkoheni ne, do bëni pushime verore gjithë jetën! Tepelena: Kodi zgjedhor i 2008 ka marrë peng demokracinë
- 2

Mbahet protesta e 44-t në Tiranë, organizatori Lika thirrje qytetarëve: pastrimit të parave (VIDEO)
- 3

Pr/rezoluta për Bankën e Shqipërisë, Braçe: Të forcoje luftën kundër
- 4

Organizatori Edison Lika nga protesta para Kryeministritë fton shqiptarët të bojkotojnë pushimet verore: Eshhtë e vetmja mënyrë që të bëni pushime gjithë jetën (VIDEO)
- 5

Ish-deputeti Spaho për Report TV: Protesta tashmë nostalgji, ka 'dhënë
- Optimizëm në ekonomi, qeveria pret GDP prej 29 miliard eurosh këtë vit, të ardhurat për frymë shkojnë rreth 12.200 euro (VIDEO)

Kronikë

Atentat në Vorë, 50-vjeçari ekzekutohet me plumb pas shpine te dera e shtëpisë! Viktima njihej si i ‘forti’ i zonës, merrej me shitblerje pronash (EMRI +VIDEO)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mesnatën e duke u gdhirë e diel në zonën e Bërxullës. Një 50 vjeçar është ekzekutuar në momentin kur po kthehej në banesë. Deri tani policia dhe prokuroria nuk kanë asnjë të dyshuar për ngjarjen, ndërsa një piste është ajo e aktivitetit të tij në shitblerjen e tokave

Atentat në Vorë, 50-vjeçari ekzekutohet me plumb pas shpine te dera

Report TV



Watch on

Redaksia 12 Korrik, 01:08 | Përditësimi: 13 Korrik, 11:38

Share Post




VORË - Detaje të reja kanë dalë në dritë lidhur me vrasjen e ndodhur pas mesnatës në fshatin Bërxullë, Vorë, ku humbi jetën 50-vjeçari Edmond (Ali) Sula. Sipas burimeve hetimore, viktima ishte duke u kthyer në banesën e tij kur u qëllua me armë zjarri, duke i sjellë vdekjen e menjëhershme. Autorët dyshohet se e kanë goditur në momentin kur ai po afrohej pranë shtëpisë.

Krimi ndodhi rreth orës 00:10 të datës 12 korrik, ku 50 vjeçari sapo kishte parkuar automjetin e tij dhe teksa i drejtohej derës së banesës, një predhë e ka goditur nga mbrapa, në shpinë duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme. Në zonë nuk janë dëgjuar të shtëna teksa burimet bënë me dije se dyshohet të jetë qëlluar ose me pushkë me dybli ose snajper.

Mësohet se viktima njihej si person me influencë në zonë, dhe pothuajse çdo ditë qëndronte tek një ambient në lagjen ku jetonte dhe ku kryente takime me të njohur por edhe persona që interesoheshin për shitblerje tokash.



LEXO EDHE:



Mbahet protesta e 44-t në Tiranë, organizatori Lika thirrje qytetarëve: Nëse na bashkoheni ne, do bëni pushime verore gjithë jetën! Tepelena: Kodi zgjedhor i 2008 ka marrë peng demokracinë

Në fakt ai ka të regjistruar në emër të tij edhe një kompani që ka si objekt shitblerje ose dhënie me qera makinash.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, po vijon punën për të zbardhur rrethanat dhe motivin e krimit, ndërsa deri tani nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit apo autorëve.

Hetimet po drejtohen nga specialistët e sektorit të vrasjeve në Policinë e Shtetit, ndërsa janë sekuestruar kamerat e sigurisë në zonë, me shpresën se pamjet do të ndihmojnë në identifikimin e autorëve dhe dokumentimin e lëvizjeve të tyre para dhe pas ekzekutimit.

Paraprakisht po hetohet rreth aktivitetit të tij me tokat, ku merrej me shitblerjen e tyre, por nuk rezulton me precedent penal në Shqipëri, por ka dhe një tjetër pistë hetimi është edhe e shkuara e tij jashtë vendit, kryesisht në shtetin Italian.

"Më datë 12.07.2026, rreth orës 00:10, në fshatin Bërxullë, Vorë, dyshohet se është vrarë me armë zjarri shtetasi E(A). S., rreth 50 vjeç, i cili ka qenë në rrugë, duke lëvizur në këmbë.

Një grup i posaçëm hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, ndodhet në vendngjarje dhe vijon punën për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, si dhe për fiksimin e çdo prove që do të ndihmojë në zbardhjen e saj, identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve të dyshuar. Shërbimet e Policisë kanë ngritur pika kontrolli dhe po ushtrojnë kontrolle në zonë, me qëllim kapjen e autorit/ëve", njofton policia.



Atentat në Vorë, 50-vjeçari ekzekutohet te de

Report TV



Watch on

Share



Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: vrasje vore Tiranë Edmond Sula

Komento

Komente

Emigranti: 12/07/2026 17:34
Nje pyetje kot nga tribuna: cfare peshon me shume te imazhi i Shqiperise kriminaliteti i perditshem apo koncerti i Qaniut (kanye)? Edhe nje tjeter: cfare i shqeteson me shume njerezit deshtimi i koncertit te Qaniut apo krimet dhe vjedhjet e perditshme?

I forti: 12/07/2026 12:13
Nuk te vret njeri kot. Dhe kh j forti dikujt i ka rene ne qaf qe ja ka bo borxh

i dobeti: 12/07/2026 17:55
gjeti ate qe kerkonte gjithe keto kohe, po ishte budalla dhe nuk i doli koha ta kuptonte.

Ndalohej rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016




Sondazhi i ditës: Gafa e sulmeve ndaj bizneseve e ka dëmtuar frymën e protestës?

10 Korrik, 22:22

Po! Jo! Disi!

Lajme të tjera



Atentati në Bërxullë nga vrasës me pagesë! Autori e qëlloi Edmond Sulën me një plumb në kokë, pistë hetimi konflikti për shitblerje pronash


Sokol Dema

13 Korrik, 11:27



E PLOTË/ Hidhet shorti i Superligës për sezonin e ri, në javën e parë spikasin ndeshjet Partizani - Teuta dhe Egnatia - Tirana

13 Korrik, 11:25




Vrau bashkëshorten për xheloz, Gjykata e Shkodrës lë në burg 64-vjeçarin! Asnjë fjalë në seancë (VIDEO)

13 Korrik, 10:34




Mijëra të rinj duke kërcyer dhe kënduar nën tingujt e muzikës së Kanye West, Gonxhja: Shqipëria historike (VIDEO)

13 Korrik, 07:35




Mbeti viktimë e një atentati në Vorë, Report Tv siguron foton e 50-vjeçarit të ekzekutuar në derë të shtëpisë

12 Korrik, 23:08



Na ndihmon suksemi i koncertit në Kashar?




Fatos Çoçoli

12 Korrik, 19:56




Protesta/ 'Review'-t negative ndaj bizneseve, aktivisti Tepelena: Hitën do e kallëzojmë në SPAK! Pjesëmarrja në turrje, sulme qytetarëve që nuk i bashkohen tubimit

12 Korrik, 19:19




I dënuar në Itali me 13 vite burg për shfrytëzim prostitucioni, 48-vjeçari arrestohet në Tiranë për t'u ekstraduar (EMRI+VIDEO)

12 Korrik, 12:18



Koncerti Kanye West në Tiranë, aktori i njohur turk publikon foto nga 'Eagle Stadium'

12 Korrik, 11:32



Shpjegimi me VIDEO: Si është e ndërtuar 'Toka' mbi të cilën Kanye West përformoi në Tiranë për 60 mijë fansa nga 80 vende të botës

12 Korrik, 10:51



Bjorn Runa: Politika që na shpëtoi, ndërsa flisnim për politikë



Bjorn Runa


12 Korrik, 09:20



Koncerti i Kanye West, Rama ndan pamjet me dron të stadiumit plot: Investim i shkëlqyer për imazhin e Shqipërisë turistike dhe ekonominë e Tiranës

12 Korrik, 08:10

Lajmi i fundit




E moshuara nga protesta: Opozita e vërtetë nuk është Berisha, por ne! Saliu bashkë me Ramiz Alinë na e vodhën demokracinë

13 Korrik, 21:18

Sh

com

Lajmi i fundit



E moshuara nga protesta: Opozita e vërtetë nuk është Berisha, por ne! Saliu bashkë me Ramiz Alinë na e vodhën demokracinë

13 Korrik, 21:18